

	KOMENTE NE RAPORTIN KONSULTATIV	FO-ÇLRR-025
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 1 nga 2</i>

18 mars 2011

Kriteret për matjen e konkurrencës efektive në furnizimin me energji elektrike

Komente në Raportin Konsultativ

1. Qëllimi i konkurrencës efektive ne furnizim është që të arrihet te një efizienz më e lartë dhe çmim më i ulët i energjisë elektrike në tregun me pakicë dhe kjo është e pa arritshme kur mungon konkurrenca në tregun me shumicë të energjisë elektrike. Konkurrenca në anën e gjenerimit duhet të jetë një nga kriteret kryesore që duhet të plotësohen për të pas konkurrencë efektive në furnizim.
2. Neni 41 pika 1.3 sipas Ligjit për Rregullatorit e Energjisë thekson se çdo konstatim i ZRRE se konkurrenca në furnizimin e energjisë elektrike nuk është efektive duhet të bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të publikuar të kushteve të tregut.

Paragrafi 1.3 i cituar me lartë nuk shihet se është shfrytëzuar në dokument.

3. Është e nevojshme gjithashtu të përcaktohen kriteret që duhet të plotësojnë Shfrytëzuesit e mëdhenj të energjisë, shfrytëzuesit energjisë në tensionin e mesëm dhe shfrytëzuesit e energjisë në tensionin e ultë për të hyrë në një treg të derregulluar
4. Për kushtet e tregut të Kosovës mendojmë se niveli prej të paktën 10% për një furnizues aktiv është i lartë .
5. Për pikën 2 dhe 3 të Raportit Konsultativ propozimet e KOSTT janë paraqitur të shënuara në tekstin e kopjuar të dokumentit si ma poshtë:

2 Përkufizimi i tregut

Duke pasur parasysh natyrën e ndërlidhur të sistemit të energjisë elektrike, ZRRE-ja propozon që tregu relevant gjeografik të jetë tërë Kosova. Meqë ngrohja qendrore nuk është zëvendësues perfekt i energjisë elektrike, ZRRE-ja gjithashtu propozon që tregu

	KOMENTE NE RAPORTIN KONSULTATIV	FO-ÇLRR-025
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 2</i>

përkatës i produktit të jetë i veçantë për furnizim me energji elektrike. Për më tepër, ZRrE-ja propozon që tregu përkatës të jetë për furnizim vjetor, për të parandaluar ndryshimin e shpeshtë të furnizuesve nga konsumatorët, për të përfituar nga koha e shfrytëzimit.

ZRrE-ja propozon që vlerësimi i konkurrencës efektive të bëhet për tregjet si më poshtë:

- Shfrytëzuesit më të mëdhenj të energjisë:** konsumatorët e kyçur në nivelin 110 kV e më lart (kategoria tarifore O₁) shfrytëzuesitë mëdhenj të konsiderohen edhe shfrytëzuesit me mbi 50 GWh ngarkesë në vit, gjë që mund të arrihet edhe në nivelin e shfrytëzuesit të energjisë në tension të mesëm
- Shfrytëzuesit energjisë në tensionin e mesëm:** konsumatorët e kyçur në nivelet 35 kV dhe 10kV (kategoritë tarifore 1 dhe 2) , shfrytëzuesit nën 50 GWh
- Shfrytëzuesit e energjisë në tensionin e ultë:** konsumatorët e kyçur në nivelin 0.4 kV dhe të klasifikuar në kategorinë tarifore 3
- Shfrytëzuesit e vegjël të energjisë në tensionin e ultë:** kategoritë tarifore 4 deri në 8

3 Kriteret e vlerësimit të konkurrencës

ZRrE-ja propozon që të bazojë vlerësimin e saj për ekzistimin e konkurrencës efektive në atë se a ka dëshmi që furnizues konkurrent kanë qenë në gjendje të hyjnë në tregun relevant dhe të kenë sukses në tërheqjen e konsumatorëve nga Furnizuesi Publik. ZRrE-ja konsideron se, për arsye të qartësisë dhe transparencës, dëshmia e përdorur në vlerësim duhet të jetë e mundshme që të definohet në terma objektiv, të qartë dhe lehtësisht të matshëm. Duke pasur parasysh këtë, ZRRE propozon që niveli i konkurrencës efektive në furnizim të vlerësohet në bazë të dy themeleve kryesore:

- Numri i furnizuesve të pavarur** (përveç Furnizuesin publik) aktiv në tregun relevant. Kjo

siguron një masë të intensitetit të konkurrencës. Për këtë arsye, ZRrE-ja propozon që të definojë një furnizues aktiv si ai që ka furnizuar mesatarisht, në vitin e kaluar, mbi 5% të tregut përkatës, matur sipas volumeve totale të konsumuara.

- Pjesa e tregut të shërbyer nga furnizuesit e pavarur.** Kjo siguron një masë të efektivitetit të furnizuesve konkurrent në tërheqjen e konsumatorëve dhe për këtë arsye aftësinë e tyre për të siguruar një kontroll mbi fuqinë e tregut të Furnizuesit publik. ZRRE propozon që standardet e mëposhtme duhen plotësuar ose tejkaluar, në mënyrë që të demonstron se në një treg ekziston konkurrenca efektive:

- Numri i furnizuesve të pavarur në tregun përkatës duhet të jetë dy ose më shumë.
- Pjesa e tregut relevant të shërbyer nga furnizuesit e pavarur duhet të tejkalojë 30%.

(fund i dokumentit)